

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË PODUJEVË - Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil, me gjyqtarin Bujar Muzaqi, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridiko-civile të Paditësit L.(H.)LI. nga Fshati S., Komuna e P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat H.P., me seli në Rrugën "...", nr..., Komuna e P., kundër të paditurit R.(T.) R., dikur nga Fshati S., Komuna e P. tani me vendbanim të panjohur diku në S., të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Avokat M.H., me seli në Rrugën "...", p.n, Komuna e P., për çështjen kontestimore vërtetim pronësie, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Avokat H.P. dhe përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit Avokat M.H., me datë 08.11.2018 morri këtë :

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET Padia e paditësit L.(H.) LI., nga Fshati S., Komuna e P. **SI E BAZUAR.**

II. VËRTETOHET se Paditësi L.LI., e ka fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmëritë të cilat evidentohen si njësi kadastrale P-71712076-00329-0, me kulturë Bujqësore – Arat – Arë e klasës 5, vendi i quajtur Gumurishtë, me sipërfaqe prej 00.27.56 ha, njësia kadastrale P-71712076-00330-0, me kulturë Bujqësore – Arat – Arë e klasës 4, vendi i quajtur Gumurishtë, me sipërfaqe prej 00.14.50 ha, njësia kadastrale P-71712076 - 00331-0, me kulturë Bujqësore – Arat – Arë e klasës 3, vendi i quajtur Gumurishtë, me sipërfaqe prej 00.36.32 ha, dhe njësia kadastrale P-71712076-00332-0 me kulturë Bujqësore – Livadhet – Livadh I klasës 3, vendi i quajtur Gumurishtë, me sipërfaqe prej 0.08.60 ha, Z.K Surkish, Certifikata nr.*numri i çertifikatës...*, Komuna e P. në bazë të shitëblerjes.

III. DETYROHET i Padituri R.(T.) R., dikur nga Fshati S., Komuna e P., t'ia njohë të drejtën e pronësisë dhe t'ia lejojë që paluajtshmëria e lartëcekur në evidencën kadastrale në Drejtorinë Kadastrale në Komunën e Podujevës të regjistrohet në emrin e paditësit L.(H.) LI., në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes të aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi L.LI. në padinë e dorëzuar në gjykatë me dt.24.02.2014 ndër të tjera ka deklaruar se *“...Paditësi me të paditurin R.R. nga fsh. S. Komuna P., kanë lidhur kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë me dt. 21.11.1976, për ngastrat kadastrale 329-0, 330-0, 331-0, 332-0 vendi i quajtur pusat e Surkishit - fshati S., Komuna e P...”,* ndërsa në parashtrësen për precizim të padisë dorëzuar në Gjykatë me datë 01.10.18 ndër të tjera ka deklaruar se *“...Paraprakisht e saktësoj se paditësi L.LI. nga fshati S. KK P. me pare (L.LI.) tani L.LI. nga I padituri R. R. po ashtu nga fshati S. tani me vendbanim te panjohur diku ne S. me dt, 21.11.1976 ne baze te kontrates te nënshkruar ne mes te shitesit dhe blerësit ka blere ngastra kadastrale: nr, 329 me kulture are ne sipërfaqe prej 00.27.56 ha nr, 00.330-0 ne sipërfaqe prej me kulture are klasa e 4 ne sipërfaqe prej 00.14.50 ha, ngastra kadastrale 00.331-0 ne sipërfaqe prej 00.36.32 ha dhe ngastra kadastrale 332-0 ne sipërfaqe prej 00.08.60 ha te gjitha ngastrat gjenden ne vendin e quajtur “Gumorisht” dhe evidentohen ne fletën poseduese nr, 67 Zona K. S. Ne sipërfaqe te përgjithshme prej 00.86.98 ha...”*.

Përfaqësuesi i autorizuar i Paditësit avokat H.P. në seancën e përgaditore të mbajtur me datë 28.09.2018, ndër të tjera ka deklaruar se *“...mbetem ne tersi pran padis dhe kërkesëpadisë te ushtruar në këtë Gjykatë, paraprakisht theksoj se mbiemri i paditësit është LI., ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 08.11.2018, ndër të tjera ka deklaruar se “...Mbetëm në tërësi pranë padisë, dhe kërkespadisë, precizimit të kërkespadisë, dhe parashtrësës, kemi dalë bashk me ekspertin në vend të ngjarjes dhe eksperti ka bërë identifikimin e ngastrave të cilat përshkruhen në ekspertizë dhe ka vërtetuar se këto ngastra i mbanë paditësi në bazë të aktit të shitblerjes- kontratës e dt. 21.11.1976, edhe njëherë deklaroi se paditësi në bazë të kësaj kontrate të lidhur me të paditurin me datën e lartëcekur i ka blerë paluejshmëritë të cilat i shfrytëzon që nga viti 1976, dhe ate ngastrat kadastrale 329-0, 330-0, 331-0, dhe 332, të evidentara në qertifikatën nr.numri i çertifikatës..., dt 03.10.2018, zona kadastrale S., sipërfaqja e përgjithshme, e kam bërë precizimin e padisë në bazë të deklaratës së paditësit i cili nuk ka qenë në gjendje ti identifikoi parcelat për shkak të moshës së tij e që është dashur të bëje precizimin e padisë për sipërfaqen- ngastrat e vërteta të cilat i ka blerë paditësi nga i padituri në vitin 1976, për çka për këtë tokë paluejshmëri gjykatës i kemi prezentuar në origjinal kopjen e kontratës dhe kopjen e pagesave të bëra nga paditësi, arsyeja pse deri më tani nuk e ka përkthye nga se shitësi pas pranimit të çmimit të shitblerjes është larguar nga Kosova dhe është vendosur me adresë të panjohur diku në Serbi. Dhe se nuk ka mundur të kontaktoi për bartjen e pronësisë. Shpenzimet nuk i kërkoi...”*.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit Av. M.H., në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.08.11.2018, ndër të tjera ka deklaruar se: *“...mbetem pranë deklaramëve të mëhershme. Jam caktuar përfaqësues i përkohshëm e kam pranuar aktvendimin për përgjigje në padi dhe tani e bëjë përgjigjen në padi në seancë jam i njoftuar me lëndën në tërësi dokumentacionin që gjindet në lëndë e kam shiquar në tërësi ku kam vërejtë se kjo lëndë është e kompletuar duke filluar prej kontratave të shitblerjes, fletpagesave, ekspertizës, fletëposedimi, verifikimit të vendit të ngjarjes të ngastrave nga eksperti ku paditësi është në posedim dhe shfrytëzim të këtyre ngastrave nga viti 1976 e deri më sot pa kurrfarë pengese nga shitësi, të gjithë jemi në dijeni se mos bartja e pronësisë nga palët serbe në palën shqiptare që i kanë ble ka qenë një vendim politik nga organet e atëhershme, dhe nuk e kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit e lëmë gjykatën që të vendosë në bazë të dokumentacioneve që gjenden në shkresat e lëndës. Shpenzimet i kërkoi sipas tarifës së OAK...”*.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 08.11.2018 u administruan provat më të rëndësishme për vërtetimin e plotë dhe të drejt të gjendjes faktike siç janë: Çertifikata nr.numri i çertifikatës..., dt 03.10.2018, Kontrata e dt.21.11.1976 e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurit për shitblerjen e paluajtshmërisë, Faturat e dt.21.11.1976 për pagesën e ratës nga ana e paditësit të paditurit, Faturat e dt.27.08.1978 për pagesën e ratës nga ana e paditësit të paditurit, Faturat e dt.27.11.1977 për pagesën e ratës nga ana e paditësit të paditurit, Faturat e dt.01.04.1979 për pagesën e ratës nga ana e paditësit të paditurit, Faturat e dt.30.04.1978 për pagesën e ratës nga ana e paditësit të paditurit, Faturat e dt.01.09.1977 për pagesën e ratës nga ana e paditësit të paditurit, Ekspertiza e përpiluar nga Eksperti i Gjeodezisë P. I. dt.08.11.2018.

Pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës provë veç e veç dhe të gjithave bashkërisht e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, kjo Gjykatë lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko – civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

- Në bazë të Çertifikatës nr.numri i çertifikatës..., dt.03.10.2018, u vërtetua se paluajtshmëria e cila është lëndë e këtij kontesti evidentohet në emër të të paditurit R.R.;

- Në bazë të Kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e lidhur me datë 21.11.1976, në Komunën e P., konstatohet se me datë 21.11.1976 është lidhë Kontrata për shitblerjen e paluajtshmërisë kontestuese ndërmjet paditësit, dhe të paditurit për shumën e përgjithshme prej 2.000.000 dinarë;

- Në bazë të dëftesës/fatura, të datës 21.11.1976 janë edhe deklaratat e nënshkruara nga ana e të paditurit për pranimin e të hollave gjegj. shumën e

përgjithshme prej 2.000,000 dinarë (dy milion dinarë të vjetër) për shitblerjen e paluajtshmërisë kontestuese, në bazë të datave të dakorduara në kontratën e shitblerjes;

- Në bazë të dëftesës/fatura, të datës 27.08.1978 janë edhe deklaratat e nënshkuara nga ana e të paditurit për pranimin e të hollave gjegj. shumën e përgjithshme prej 2.000,000 dinarë (dy milion dinarë të vjetër) për shitblerjen e paluajtshmërisë kontestuese, në bazë të datave të dakorduara në kontratën e shitblerjes;

- Në bazë të dëftesës/fatura, të datës 27.11.1977 janë edhe deklaratat e nënshkuara nga ana e të paditurit për pranimin e të hollave gjegj. shumën e përgjithshme prej 400.000 dinarë (katërqind dinarë të vjetër) për shitblerjen e paluajtshmërisë kontestuese, në bazë të datave të dakorduara në kontratën e shitblerjes;

- Në bazë të dëftesës/fatura, të datës 01.04.1979 janë edhe deklaratat e nënshkuara nga ana e të paditurit për pranimin e të hollave gjegj. shumën e përgjithshme prej 20.000 dinarë (njëzet mijë dinarë të vjetër) për shitblerjen e paluajtshmërisë kontestuese, në bazë të datave të dakorduara në kontratën e shitblerjes;

- Në bazë të dëftesës/fatura, të datës 30.04.1978 janë edhe deklaratat e nënshkuara nga ana e të paditurit për pranimin e të hollave gjegj. shumën e përgjithshme prej 3.000,000 dinarë (tre milion dinarë të vjetër) për shitblerjen e paluajtshmërisë kontestuese, në bazë të datave të dakorduara në kontratën e shitblerjes;

- Në bazë të dëftesës/fatura, të datës 01.9.1977 janë edhe deklaratat e nënshkuara nga ana e të paditurit për pranimin e të hollave gjegj. shumën e përgjithshme prej 2.150,000 dinarë (dy milion e njëqind e pesëdhjetë mijë dinarë të vjetër) për shitblerjen e paluajtshmërisë kontestuese, në bazë të datave të dakorduara në kontratën e shitblerjes;

- Se është lidhë kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e cila është objekt i kësaj procedure kontestimore këtë e vërtetuan edhe dëshmitarët dhe atë dëshmitarët A.T. nga Fshati S., Komuna e P., F.T. me vendbanim në Rrugën "...", Komuna e P. dhe Sh.S. nga Fshati S., Komuna e P. të cilët në seancën e dt.28.09.2018 ndër të tjera deklaruan dhe atë dëshmitari A.T. në seancën e dt.28.09.2018 ndër të tjera deklaroi se *"...emrin e shitësit nuk e di mirëpo e di që prej serrbëve e ka blerë, e kam pa L. kah*

punon në këto prona diku prej vitit 1970...”, dëshmitari Sh.S. në seancën e dt.28.09.2018 ndër të tjera deklaroi se “...unë e mbaj men që këto prona L. i ka bler prej R. diku para 30-40 viteve, unë kur kam qenë me i ri vet kamë punuar në këto në prona , vetem e di që këto prona jan të tija...”, dhe dëshmitari F.T. në seancën e dt.28.09.2018 ndër të tjera deklaroi se “...unë e di që këto prona i ka bler para 30-40 viteve, dhe jamë në dijeni se i njëjti i punon këto prona...”.

- Në bazë të ekspertizës të përpiluar nga eksperti i Gjeodezisë P.I. me dt.06.11.2018, ndër të tjera ka konstatuar se “... Në vazhdim do të paraqitet gjendja reale në teren e datës 06.11.2018. me datën 06.11.2018 ishim në vendin e ngjarjes ku në prezenc të shfrytëzuesit të parcelave L.H.L. dhe përfaqësuesit ligjor të tij kemi bërë identifikimin e gjendjes faktike në terren ku dhe do ti paraqesim në vijim. Të gjitha keto parcela që paraqiten në vijim i shfrytëzon L.H.LI. : Parcela me numrin kadastral 329-0 me kulturë are 5 sipërfaqe 2756 m², Parcela me numrin kadastral 330-0 me kulturë are 4 me sipërfaqe 1450 m², Parcela me numrin kadastral 331-0 me kulturë are 3 me sipërfaqe 3632 m² dhe Parcela me numrin kadastral 332-0 me kulturë livadh 3 me sipërfaqe 960 m²...”.

Andaj Gjykata, duke marrë për bazë kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e lidhur me datë 21.11.1976 ndërmjet paditësit, dhe të paditurit, deklaratave të thëna nga paditësi në seanca gjyqësore, dëgjimin e dëshmitarëve, ekspertizes së ekspertit të gjeodezisë, dhe duke marrë për bazë që kjo e drejtë e paditësit ka qenë e bazuar edhe në nenin 20 par.1, nenin 28.2 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike - pronësore, ndërsa tani është e rregulluar me nenin 36 par.1, 40 të Ligjit nr.03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, shpalli aktgjykim për çka vendosi sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet procedurale, Gjykata vendosi konform dispozitës së nenit 450 par.1 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale të shkaktuara me veprimet e veta procedurale.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË
Departamenti i përgjithshëm- Divizioni Civil
C.nr.113/14 datë 08.11.2018

Gjyqtari,
Bujar Muzaqi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.